

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2022

<u>ftn1</u>	<u>ftn2</u>	<u>ftn3</u>	<u>ftn4</u>	<u>ftn5</u>	<u>ftn6</u>	<u>ftn7</u>
1	9 Qershor 2022	1. A ka ASPA një dokument strategjik ose zhvillimor të arsimit të nëpunësve civilë mbi të cilën ndërton programin e trajnimit? Nëse po, a mund të mundësoni një kopje? 2. A ka identifikuar ASPA institucione që janë më tepër të ekspozuara ndaj korrupsionit dhe risqeve të tjera të integritetit institucional për shkak të natyrës së sektorëve për të cilat janë përgjegjëse, si p.sh. infrastruktura dhe energjia; siguria dhe mbrojtja? Nëse po, a ka programe të posaçme për nëpunësit e këtyre institucioneve?	15 Qershor 2022	<p>1. A ka ASPA një dokument strategjik ose zhvillimor të arsimit të nëpunësve civilë mbi të cilën ndërton programin e trajnimit? Nëse po, a mund të mundësoni një kopje?</p> <p>ASPA harton kalendarin e trajnimit bazuar në proceset e punës që zhvillon në bashkëpunim me institucionet publike, por jo në bazë të një dokumenti strategjik të mirëfilltë në kuptimin klasik të strategjisë. Kalendarin e trajnimit i ASPA bazohet në nevojat që identifikohen nga procesi i vlerësimit të nevojave në shkallë vendi (aktualisht Vlerësimi i Nevojave për Trajnimit 2021-2022); detyrime që burojnë nga kuadri strategjik në nivel kombëtar; detyrime ligjore; mbështetje për procesin e integritetit dhe kërkesa të tjera për trajnim ardhur nga institucionet. Bazuar në këto burime ASPA harton kalendarin e trajnimit duke vendosur prioritetet përkatëse.</p> <p>2. A ka identifikuar ASPA institucione që janë më tepër të ekspozuara ndaj korrupsionit dhe risqeve të tjera të integritetit institucional për shkak të natyrës së sektorëve për të cilat janë përgjegjëse, si p.sh. infrastruktura dhe energjia; siguria dhe mbrojtja? Nëse po, a ka programe të posaçme për nëpunësit e këtyre institucioneve?</p> <p>ASPA zhvilloi vlerësimin e nevojave për trajnim Antikorrupsion gjatë muajve tetor-nëntor 2020 dhe hartoi kurrikulën 'Antikorrupsionit dhe konflikti i interesit', me mbwshetjen e projektit të financuar nga BE "Ndihma teknike për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit - Kontrata e Reformës së Sektorit për Luftën kundër Korrupsionit". Në arkivën e ASPA janë dy kurrikula të hartuara në vitin 2018: 'Etika në Administratën Publike dhe Konflikti i Interesave' dhe 'Korrupsioni në Administratën Publike, mekanizmat e identifikimit dhe lufta ndaj tij'. Në periudhën 3-4 Mars 2021 ASPA në bashkëpunim me projektin e financuar nga BE "Ndihma teknike për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit - Kontrata e Reformës së Sektorit për Luftën kundër Korrupsionit" zhvilloi TOT "Integrity Plan and Risk Assessment" ku u trajtuan çështjet e Vlerësimit të Riskut, Risku i Integritetit, Faktorë të Riskut të Integritetit, Procese dhe Fusha të Vlerësimit të Riskut. Ka vijuar trajnimi në klasë për pikat e kontaktit antikorrupsion gjatë periudhës Qershor 2021 - Janar 2022 ku janë zhvilluar 9 trajnime për pikat e kontaktit antikorrupsion.</p> <p>Trajnim në fushën e antikorrupsionit dhe konfliktit të interesit është i vijueshëm dhe ofrohet për të gjithë punonjësit e institucioneve publike, sipa specifikave që ata kanë siç janë përshembull pikat e kontaktit antikorrupsion.</p>	E plote	Nuk ka tarifë